



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.12.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 13, 1 dhe 2, 19 dhe 20 nëntor 2018.
2. Shqyrtimi i çështjes së konfliktit të interesit të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu.
3. Diskutimi i korrespondencës drejtuar komisionit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Bujar Çela dhe Besnik Baraj (zëvendesues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj dhe Shezai Rrokaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi - Mirëdita!

Jemi mbledhur sot për të zhvilluar mbledhjen e radhës, sipas kalendarit të miratuar, për të marrë në shqyrtim raportin e përgatitur për lirimin nga detyra të zotit Zylyftar Bregu, i cili ka një konflikt interesi, sipas ligjit nr. 9367, viti 2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në Shqipëri”, i ndryshuar” dhe sipas nenit 12 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Në fakt, deri më sot ne jemi mbledhur disa herë për këtë çështje, por para se të hap mbledhjen e sotme dua t’ia kaloj fjalën zotit Fidel Ylli, që të më thotë nëse kuorumi është i përshtatshëm për të vazhduar këtë mbledhje, apo jo?

Fidel Ylli - Kourumi është i përshtatshëm, por më vjen shumë keq jo vetëm për opozitën, por edhe për zonjushën Mehmetaj, e cila ka kërkuar që ky komision të shqyrtojë me përgjegjshmëri problemin e zotit Bregu dhe përsëri ka bojkotuar dhe nuk ka ardhur. Gjithsesi, ne do ta vazhdojmë procedurën normalisht.

Milva Ekonomi – Para se të kalojmë te diskutimet, dua t’ju pyes në qoftë se e keni parë rendin e ditës dhe procesverbalet që ka përgatitur për ne sekretaria, që i kemi marrë nëpërmjet adresës elektronike, të datave 13, 1 dhe 2, 19 dhe 20 nëntor 2018? Pra, a i keni parë procesverbale? A jeni dakord me procesverbalet? Në rregull.

Atëherë, kalojmë në shqyrtimin e çështjes së konfliktit të interesit për anëtarin e AMA-s, zotin Zylyftar Bregu. Deri tani kemi zhvilluar katër mbledhje dhe kemi rreth 1 muaj e gjysmë që merremi me shqyrtimin e kësaj çështjeje. Në adresat tona elektronike është shpërndarë një relacion, i cili, në fakt, është një relacion mbi të gjitha materialet që janë grumbulluar deri tani dhe nuk përbën raportin tonë definitiv. Domethënë, çdo çështje që është diskutuar deri tani në komision gjatë të katra mbledhjeve dhe dëgjësave që kemi bërë, është depozituar e gjitha aty dhe është përmbledhur.

Në bazë të këtij relacioni ose të këtij dokumenti parlamentar që kemi, ne do të marrim një vendim. Unë nuk e di në qoftë se ju keni pasur kohë ta lexoni plotësisht relacionin, apo dëshironi që të bëjmë një lexim të përbashkët të dokumentit? E keni lexuar.

Domethënë, ne gjendemi në situatën e konfliktit të interesit dhe të gjitha kërkesat që paraqiti këtu avokati i zotit Bregu, kur e thirrëm në dëgjësë, u morën në konsideratë nga komisioni ynë, u konsultua edhe me Shërbimin Juridik dhe me Shërbimin e Monitorimit në Kuvend dhe u konstatua se konflikti i interesit është një konflikt i shfaqur aty. Mendoj se në

qoftë se ju jeni dakord me relacionin, nuk ka ndonjë gjë për të diskutuar. A ka dikush ndonjë gjë për të diskutuar për relacionin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mendoj se është mirë të themi se komisioni, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes dhe pasi dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga anëtari i AMA-ës, mbështetur nga sa më lart, konstaton se: zoti Zylyftar Bregu është në kushtet e shkeljes së ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit” prej 3 vjetësh, pasi ka lidhur kontratë me institucionet publike në kushtet kur ishte e ndaluar në mënyrë absolute një veprim i tillë. Ky veprim bie ndesh me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Autoritetit të Medieve Audiovizive. Mendoj se është mirë që, për ta pasur të dokumentuar, të kalojmë në leximin e relacionit që kemi përgatitur.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit përgjegjës për shqyrtimin e kësaj çështjeje, është mbledhur në disa data dhe ka marrë në shqyrtim kërkesën e kryetarit të AMA-s “Për lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu”, për shkak të publikimit të gjendjes së konfliktit të interesit të këtij anëtari, parashikuar në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si ndalesë absolute në ushtrimin e detyrës së një anëtari të Entit Rregullator”.

Rrethanat e çështjes:

Me shkresën nr. 3403/1, datë 01.11.2018, Gentian Sala, kryetar i AMA-s, i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë me kërkesën për lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu.

Arsyetimi i dhënë në këtë kërkesë është se ky anëtar, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për ushtrimin e mandatit dhe konkretisht me ligjin organik të AMA-s nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe me ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka lidhur një kontratë qiraje me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila është bazuar në ligjin nr. 8318/1998 “Për dhënien e tokave bujqësore me qira”, për një sipërfaqe prej 4,82 hektarësh në fshatin Picar, Bashkia Vorë, me një afat përdorimi për 99 vjet. Ky fakt i është njoftuar zyrtarisht Kuvendit nga kryetari i AMA-s, është bërë publik në media nga “City News Albania” rreth një muaj më parë. Fakti i raportuar në media, i cili u bë shkak për fillimin e trajtimit të çështjes, përmes njoftimit nga kryetari i AMA-s, është shoqëruar nga ky i fundit me kopje të skanuar të kontratës së nënshkruar nga palët lidhur midis zotit Zylyftar Bregu, si person fizik i regjistruar

në bazë të legjislacionit përkatës, në cilësinë e qiramarrësit, dhe Ministrisë së Bujqësisë, në cilësinë e qiradhënësit.

I - Veprimet paraprahe nga organet dhe strukturat e Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit, para se t'ia përcillte për shqyrtim komisionit përgjegjës materialin e dërguar nga kryetari i AMA-s, i ka kërkuar sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit që të verifikojë paraprakisht të dhënat e paraqitura në këtë material dhe të vijohet më tej me procedurat e përcaktuara, sipas legjislacionit përkatës, që rregullon këtë marrëdhënie, dhe dispozitave të Rregullores së Kuvendit. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka kërkuar Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nëse ka një kontratë të lidhur midis palëve, me qëllim vërtetimin e besueshmërisë së indicies në prova dhe të bazuar në ligj, duke siguruar informacionin në mënyrë të ligjshme dhe verifikuar atë zyrtarisht.

Me shkresën nr. 3403/3, datë 08.11.2018, është administruar përgjigjja e Ministrisë së Bujqësisë, e cila ka shpjeguar kronologjinë që nga momenti i lidhjes së kontratës korrik 2015 dhe deri më sot. Informacioni është shoqëruar me kontratën nr. Prot. 5548, nr. 1539 të Repartit, nr. 425/1 të Kol., datë 07.02.2015 midis palëve: qiradhënësit -Ministria e Bujqësisë dhe qiramarrësit- Zylyftar Bregu, si dhe me kartelën e regjistrimit të pasurisë pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Nga ky informacion rezulton se zoti Zylyftar Bregu ka zhvilluar aktivitet në tokën e marrë me qira, si dhe ka kryer investime në një vlerë mbi 1 milion lekë, ndërkohë është në zhvillim të aktiviteteve të tjera të lidhura me tokën dhe ka kryer rregullisht pagesat e qirasë për periudhën 2015-2018.

Po ashtu, u krye verifikimi *online* në regjistrimin publik të Qendrës së Regjistrimit të Biznesit dhe rezultoi se zoti Zylyftar Bregu ishte regjistruar si person fizik në shkurt 2015 me fushë veprimtarie “kultivim ullishteje dhe agrumesh”, si dhe statusi i këtij aktiviteti ishte aktiv. Pasi është vënë në dispozicion nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural një kopje e kontratës së publikuar në media, së bashku me shpjegimin përkatës që nga momenti i aplikimit të zotit Bregu për të marrë pjesë në këtë procedurë, duke vijuar me tej me vlerësimin e fituesit, lidhjen e kontratës, si dhe me zbatimin e saj deri tani, të gjithë informacionin e administruar, sekretari i Përgjithshëm ia vuri në dispozicion Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si komisioni përgjegjës për shqyrtimin e çështjes.

Veprimet e komisionit

Komisioni, në ushtrim të funksioneve të tij kushtetuese parlamentare, ka autoritetin për të kontrolluar zbatimin e ligjeve në fuqi. Në këtë rast, objekt shqyrtimi është ky komision, i cili ka atributin për të propozuar lirimin nga detyra të anëtarit të AMA-s, nëse konstaton se

është në papajtueshmëri të ushtrimit të detyrës, sipas përcaktimeve të legjislacionit që rregullon këtë marrëdhënie.

Baza ligjore për shqyrtimin e çështjes:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Neni 6 i KEDNJ-së;
- Kodi i Procedurës Administrative ;
- Ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit”;
- Ligji nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”;
- Rregullorja e Kuvendit;
- Kodi i sjelljes së anëtarëve të AMA-s;

Veprimet procedurale të komisionit, në respektim të legjislacionit sa më sipër:

- Mbledhja e Komisionit për njohjen e çështjes, duke marrë si indicie jo vetëm kërkesën e kryetarit të AMA-s, por edhe njohjen nëpërmjet publikimit të kontratës së qirasë në medie për fillimin e shqyrtimit të rastit të anëtarit, zotit Zylyftar Bregu, duke u bazuar më tej në dokumentacionin zyrtar të paraqitur nga Ministria e Bujqësisë;

- thirrja e zotit Bregu për t’u paraqitur në seancë dëgjimore në komision, pas njohjes së tij me veprimet e deriatëhershme të komisionit dhe dokumentet e administruara;

- paraqitja e zotit Bregu në seancën e thirrur nga komisioni dhe kërkesa e tij për t’i dhënë kohë për të përgatitur shpjegimet;

- përgjigjja anëtarëve të opozitës joprezentë në mbledhjet e komisionit të zhvilluara për këtë qëllim, por të adresuara me shkrim;

- thirrja e zotit Bregu në një seancë të dytë dëgjimore në komision, pas afatit të kërkuar prej tij;

- mosparaqitja e zotit Bregu datën e planifikuar nga komisioni dhe marrja në konsideratë e shtyrjes së afatit për t’u dëgjuar në një datë tjetër;

-administrimi nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të një dokumentacioni më të plotë lidhur me kontratën e lidhur midis palëve qiradhënëse dhe qiramarrëse;

- dëgjesa e zotit Bregu së bashku me përfaqësuesin ligjor të autorizuar prej tij;

- administrimi pas kërkesës së komisionit, i shpjegimeve të paraqitura me shkrim nga përfaqësuesi ligjor i zotit Bregu, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur këtyre shpjegimeve.

Gjatë gjithë këtij ndërveprimi midis komisionit dhe anëtarit të AMA-s, zotit Bregu është komunikuar me shkresë zyrtare, me komunikim elektronik dhe konfirmime telefonike, bazuar në njoftimet që parashikon Kodi i Procedurës Administrative.

Seanca dëgjimore.

Në seancën dëgjimore të datës 26.11.2018 zoti Bregu u paraqit së bashku me avokatin e tij. Edhe pse prezenca e avokatit nuk ishte njoftuar më parë në komision, komisioni garanoi pjesëmarrjen e tij dhe mundësinë për mbrojtjen e parashtruar nga avokati i autorizuar prej zoti Bregu.

Zoti Bregu dhe përfaqësuesi ligjor i tij parashtruan shpjegimet dhe pretendimet e tyre për trajtimin e rastit nga ana e komisionit, duke kërkuar në fund të fjalës së tyre pushimin e procedurës së komisionit për shqyrtimin e kërkesës së kryetarit të AMA-s për lirim nga detyra.

Në seancë u pranua nga vetë zoti Bregu se ai kishte lidhur kontratë me qira për 99 vjet me institucion publik, Ministrinë e Bujqësisë, në vitin 2015, në sasi prej 4,82 hektarësh tokë në fshatin Picar, Vorë, Tiranë.

Më tej, zoti Bregu dhe përfaqësuesi i tij ligjor shpjeguan se:

- toka e marrë me qira është deklaruar në ILDKPKI-në;
- është bërë konsultimi me juristin e institucionit të AMA-s dhe ai nuk kishte konstatuar me këtë situatë të re juridike nëse anëtari i AMA-s kishte pengesë për të ushtruar detyrën;

- zoti Bregu pretendon se ILDKPKI-ja nuk i ka konstatuar gjatë deklarimit të pasurisë dhe kontrolleve të fundit të kryera për të, ndonjë pengesë apo shkelje të konfliktit të interesit për këtë rast;

- avokati pretendon se komisioni nuk duhej të niste procesin, pasi kryetari i AMA-s nuk e ka paraqitur këtë kërkesë në Këshillin e AMA-s dhe se nuk është kryer verifikimi i provës për konfliktin e interesit nga ky i fundit, para se të dërgohej në Kuvend;

Nga disa dokumente që vetë mbrojtja ligjore deklaroi se kishte bashkëlidhur materialit të parashtruar, komisioni, pasi kërkoj këtë dokumentacion, u njoh me:

- kopjen e deklaratës së pasurisë;
- shkëmbimin e fotove me kryetarin e AMA-s për tokën;
- shkëmbimin e korrespondencës me inspektoren e ILDKPKI-së;
- njoftimi që zoti Bregu i ka kërkuar ILDKPKI-së për ta njohur atë me rezultatet e verifikimit të kryer në vitin 2017 për pasurinë e tij dhe gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Analiza ligjore e komisionit.

Komisioni, pasi administroi të gjithë dokumentacionin për çështjen, kreu procesin e shqyrtimit të çështjes së konfliktit të interesit në mbështetje dhe bazuar kryesisht në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit” për arsyet e më poshtme:

Komisioni konstatoi se, bazuar në rastet e papajftueshmërisë dhe konfliktit të interesit të anëtarëve të AMA-s, të parashikuara specifikuat në nenin 7 të ligjit 97/2013, rasti për trajtim nuk ka të bëjë me këto parashikime të ligjit organik, por janë disa parashikime të ligjit kuadër të trajtimit të konfliktit të interesit, përkatësisht të nenit 21 të tij, i cili ndalon në mënyrë absolute lidhjen e kontratave të personave dhe zyrtarëve të zgjedhur, ku bën pjesë edhe anëtari i Autoritetit të Mediave Audiovizive me një institucion publik.

Një anëtar i AMA-s, në cilësinë e anëtarit të një enti rregullator, është i parashikuar në nenin 21, pika 1, në nenin 21, pika 6, si dhe në nenin 30 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Po ashtu, anëtari i AMA-s është i parashikuar edhe në ligjin organik 97/2013, ku është traspozuar si dispozitë ndalimi i detajuar dhe konkretizuar për rastet në fushën e medias. Në bazë të nenit 26 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, pika 1 e tij: “Llojet dhe kufizimet e interesave private të kategorive të zyrtarëve të përcaktuara në këtë seksion, nuk përjashtojnë llojet dhe kufizimet e përcaktuara në ligje të tjera për këto kategori zyrtarësh, të zbatuara për të njëjtin qëllim, por në çdo rast zbatohet kufizimi i rreptë, në përputhje me përcaktimet e nenit 5 të këtij ligji”.

Pra, i gjithë rasti konkret është objekt i shqyrtimit të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, nenit 21 të tij, i cili ka përcaktuar kategoritë e veçanta të funksionarëve, që për shkak të funksionit të tyre në institucione të larta kushtetuese dhe të krijuara me ligj, ka parashikuar ndalime të natyrës absolute për t’u vënë në lëvizje nga këta zyrtarë.

Konkretisht :

Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit” parashikon kufizime në nenin 2, paragrafin 1 të tij: Ndalimin e lidhjes së kontratave me institucione publike:

“Kategoritë e zyrtarëve, përcaktuar në kreun III, seksioni II, të cilëve iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me palë një institucion publik, janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat ose zëvendësministrat, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, anëtarët e enteve rregullatore, Këshilli i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe zëvendësguvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit, energjisë, furnizimit me ujë, të sigurimeve, letrave me vlerë, medieve, sekretarët e Përgjithshëm të

institucioneve qendrore, si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike, që nuk janë pjesë e shërbimit civil.”

Siç vërehet, anëtari i Entit Rregullator të medieve, në këtë rast zoti Zylyftar Bregu, hyn në atë kategori zyrtarësh që u ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me palë institucion publik.

Sa më lart, zoti Bregu, ushtron mandatin e anëtarit të AMA-s, në shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit” që prej vitit 2015 e deri më sot.

Ndërkohë, bazuar në nenin 30 po të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, kufizimet për anëtarin e organit të autoritetit rregullator: “Për anëtarin e organit të një autoriteti rregullator ose të mbrojtjes së konkurrencës, përfshirë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zëvendësguvernatorin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të saj:

a) zbatohen të gjitha kufizimet dhe lejimet e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji.

Ndër të tjera, kufizime, sipas pikës c), të nenit 31, janë edhe: “nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme....”etj.

Në kuptim të këtyre dy dispozitave të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, këto dy parashikime përbëjnë dy ndalime të natyrës absolute të lidhura me kategorinë e zyrtarit dhe funksionin e tij në administratën e lartë publike.

Në një shpjegim më të hollësishëm, ligji “Për konfliktin e interesit” kërkon që zyrtari, nga njëra anë, të kryejë detyrat publike dhe, nga ana tjetër, ka detyrimin për të parandaluar çdo lloj konflikti të interesit që mund të shfaqet në një situatë të caktuar.

Bazuar në detyrimet e ligjit “Për konfliktin e interesit”, çdo zyrtar, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në një institucion publik, është i detyruar të lëshojë një autorizim në favor të institucionit publik ku ushtron funksionet, nëpërmjet të cilit ai e autorizon këtë institucion që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për zyrtarin, kudo ku ato janë regjistruar.

Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.

Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Institucioni i AMA-s, këshilli dhe kryetari i AMA-s janë organe eprore të anëtarit. Më së fundmi, Kuvendi i Shqipërisë është institucion epror i anëtarit të AMA-s, bazuar në ligjin nr. 97/2013, neni 12 i tij “Kuvendi është organi që zgjedh dhe shkarkon anëtarët e AMA-s”. Vetë ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit” ka renditur disa organe që duhet të informohen, evidentojnë dhe trajtojnë rastet e konfliktit të interesit të punonjësve apo zyrtarëve që janë subjekt i ligjit, me qëllim që të veprojnë në çdo rast të mosveprimit apo moskonstatimit nga një hallkë e mëparshme brenda vetë institucionit.

b) Ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar”.

Anëtari i Këshillit të AMA-s, zoti Zylyftar Bregu, është funksionar i zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë dy herë radhazi në funksionin e anëtarit të AMA-s. Për shkak të këtij funksioni publik të lartë, ky anëtar është edhe subjekt i ligjit “Për deklarimin e pasurisë” dhe ligjit “Për konfliktin e interesit”.

Ai është i detyruar që t’u përgjigjet kërkesave dhe detyrimeve të këtyre ligjeve, si dhe të jetë objekt kontrolli për to. Ai duhet të jetë në dijeni të kërkesave, ndalimeve dhe kufizimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar”, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

Kjo përbën një arsye pse në kuptimin e ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive”, ku zyrtari është subjekt i deklarimit, si dhe ligjit për konfliktin e interesit, anëtari, zoti Bregu, mund të ishte konsultuar me ILDKPKI-në për marrëdhënien e lindur në vitin 2015.

Në fund të këtij vlerësimi, Kuvendi do të njoftojë edhe ILDKPKI-në për trajtimin e këtij rasti.

c) Ligji nr. 97/2013, neni 7, pika, 3: “AMA harton dhe miraton një kod sjelljeje lidhur me rregullimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005”.

Kodi i sjelljes së anëtarëve të AMA-s, miratuar me vendimin nr. 56, datë 04.04.2016 të AMA-s, ka të miratuar edhe një kod sjelljeje për mënyrën e veprimeve dhe detyrimeve që duhet të mbajnë në vëmendje gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre anëtarët e AMA-s.

Vetë kodi vendos rregulla që anëtarët duhet t’i përmbahen dhe të përmbushin detyrën e tyre në pajtim, ndër të tjera, edhe me parimin e ligjshmërisë, parimin e parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave dhe zbatimin e detyrimeve, promovimin e vlerave të institucionit dhe ushtrimin e detyrës në interes të publikut, me qëllim krijimin e besueshmërisë dhe dinjitetit të punonjësit të shtetit dhe figurës së zyrtarit.

Ky akt i Këshillit të AMA-s, i dalë në zbatim të ligjit organik dhe ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, përforcon edhe më shumë dijeninë dhe detyrueshmërinë për zbatimin e këtij ligji, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zyrtari i zgjedhur anëtar i AMA-s. Nenet 5 dhe 6 të këtij kodi përcaktojnë ndalimet e anëtarit, si dhe detyrojnë anëtarin të mos kryejë, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, veprimtari që i ndalohen për shkak të funksionit dhe të zbatojë gjithë kohën ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit”.

Lidhja e kontratës me institucion shtetëror është rast ndalues i pastër për çdo zyrtar që ka një funksion të tillë apo hyn në këtë kategori që përcakton ligji specifik.

III. Situata e mandateve të anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, dhe ushtrimi i tyre në paligjshmëri.

Zoti Bregu është duke ushtruar mandatin e dytë në këshillin e AMA-s. Në kohën kur ky anëtar ishte në ushtrim të mandatit të parë ka lidhur kontratën. Aktualisht, më shumë se tre vjet pas kontratës së lidhur, janë krijuar pasoja dhe anëtar i AMA-s ka përfutur në kushtet e ndalesës tokën dhe përfitimet e saj.

Z.Bregu, në dijeni të rolit dhe detyrimeve që rrjedhin nga funksioni i anëtarit të AMA-s, si dhe në dijeni edhe të detyrimit për zbatim të ligjit për konfliktin e interesit, duhej të kishte parandaluar/përfunduar këtë marrëdhënie me Ministrinë së paku, që para se të rizgjidhej anëtar për herë të dytë i AMA-s në korrik 2016. Vlen të theksohet se z.Bregu ka vijuar në mënyrë të pandërprerë të ushtrojë mandatin e anëtarit të AMA-s, që prej vitit 2010 e deri më sot, kur edhe në përfundim të mandatit të parë 5 - vjeçar në 22 korrik 2015, për shkak të parashikimeve të ligjit 97/2013, i cili njeh vazhdimësinë e qëndrimit në detyrë të anëtarit deri në zgjedhjen e pasuesit, nga data 22 korrik 2015 deri në 22 korrik 2016, kur është rizgjedhur në mandatin e dytë 5 –vjeçar, ka vijuar të ushtrojë detyrën e anëtarit të AMA-s.

Zoti Bregu në kohën e lidhjes së kontratës ka qenë në ushtrim të rregullt të funksionit të AMA-s brenda mandatit të parë dhe ka qenë në kushtet flagrante të shkeljes së ligjit “Për konfliktin e interesit”.

Për sa më lart, ky anëtar ka pasur kohë më se të mjaftueshme dhe nuk ka pasur asnjë pengesë për të qenë në dijeni të ndalimeve dhe masave përkatëse për t’i zgjidhur apo për t’i parandaluar ato që në kohën kur ishte anëtar e më tej, përsëri, gjatë rizgjedhjes për herë të dytë e në vijim.

IV - Shpjegime lidhur me pretendimet e mbrojtjes ligjore, të përfaqësuar nga zoti Bregu dhe avokati i tij.

Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk duhej të merrte parasysh një kërkesë të Kryetarit të AMA-s të pakonstatuar dhe të pakonsultuar me vendim të së paku 5 anëtarëve të AMA-s, komisioni arsyeton se:

-I gjithë rasti trajtohet bazuar në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Sipas këtij ligji, bazuar në pikën 2 të nenit 41, autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë:

- a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik;
- b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara apo të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik;
- c) institucionet eprorë.

Bazuar në nenin 10 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”:

“Këto autoritete, në përputhje me mënyrën dhe radhën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose në aktet nënligjore e rregulloret e brendshme të një institucioni publik, të nxjerra në zbatim të këtij ligji, janë të autorizuar që në mënyrë aktive dhe në emër të institucionit publik përkatës:

- a) të mbledhin nga burimet e ligjshme të informacionit të dhëna për interesat private të një zyrtari;
- b) të pranojnë informacionet e siguruara në mënyrë të ligjshme;
- c) të verifikojnë besueshmërinë e këtyre informacioneve;
- ç) të vënë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruara për të;
- d) t’i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
- dh) të bëjë regjistrimin e interesave privatë të zyrtarit.”

Autoriteti i parë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, në raport me verifikimin e rasteve, është vetë AMA. Ndërkohë që autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e ligjit të konfliktit të interesit është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Inspektorati i Lartë vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij.

Sipas hierarkisë, titullari i institucionit, që përfaqëson edhe marrëdhëniet me të tretët dhe me Kuvendin, ku është zgjedhur dhe jep llogari institucionale, është kryetari i Këshillit të AMA-s, zoti Gentian Sala. Zoti Sala ka iniciuar procesin, duke njoftuar në Kuvend, organin zgjedhës dhe shkarkues të Këshillit të AMA-s, faktin e zbuluar në media.

Sa më sipër, komisioni thekson se çdo e dhënë apo burim informacioni për interesat privatë të një zyrtari, subjekt i ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, mund të

sigurohet nga persona të tretë apo dhe nga burime të tjera të ligjshme, si nga media, nga publiku, nga regjistra publikë e privatë dhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm. Por secili prej këtyre burimeve ka të drejtë ta ofrojë këtë informacion sapa ai vihet në dijeni të tyre. Këtë detyrim e përcaktojnë nenet 7 dhe 8 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”.

Kuvendi i Shqipërisë dhe, nëpërmjet tij, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, janë institucione epror, në kuptim të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesit. Si i tillë, Kuvendi ka të gjithë tagrin dhe detyrimin të monitorojë, të analizojë dhe të konstatojë shkeljet përkatëse të ligjit organik, si dhe të ligjeve të tjera, të cilat hyjnë apo prekin funksione që parashikohen në ligjin e medieve.

Pretendimet e mbrojtjes së zotit Bregu lidhur me veprimet/mosveprimet e organeve të tjera të ngarkuara me detyra të posaçme nga ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit” nuk prekin dhe as ndalojnë veprimet e komisionit, si organi vendimmarrës dhe legjitim për të trajtuar çështjen proceduralisht dhe në themel të saj, në zbatim të detyrimeve ligjore, të njohura tashmë jo vetëm në kuptim të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesit, por edhe të ligjit organik të medieve audiovizive dhe të Rregullores së Kuvendit.

Bazuar në këtë ligj, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, çdo interpretim ligjor apo gjykim lidhur me ligjshmërinë e veprimtarisë së një institucioni të pavarur kanë karakter thjeshtë orientues, pasi janë organet e ngarkuara nga ligji dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, jo vetëm kanë detyrimin të zbatojnë ligjin, por kanë edhe të drejtën ta interpretojnë atë.

Bazuar në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, institucioni epror, në këtë rast është Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet Komisionit parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, i cili ka të gjithë diskrecionin për të trajtuar rastin që në momentin kur merr dijeni dhe, pas verifikimit të tij, të konkludojë me zgjidhjen përkatëse, për aq sa ligji i posaçëm ia ka deleguar këtë zgjidhje. Detyrimet dhe vendimmarrjet e autoriteteve që ligji i ngarkon me përgjegjësi janë të ndryshme për secilin prej tyre.

Secili organ, i parashikuar nga ligji i parandalimit të konfliktit të interesit, ka kompetencat e tij ligjore për të marrë masat përkatëse. Kompetencat e ILDKPKI-së janë të ndryshme për trajtimin e rastit nga ato të institucionit epror, në këtë rast të Kuvendit. ILDKPKI-ja, edhe në rast se vihet në lëvizje nga institucioni epror, pala e interesuar apo dhe vetë kryesisht, zhvillon hetimin e saj duke konkluduar për rezultatin e hetimit.

ILDKPKI-ja në çdo rast, kur trajton një konflikt, procedon sipas hapave të parashikuar në ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. ILDKPKI-ja merr masat administrative:

- marrjen e nismës për shpalljen e pavlefshmërisë në rrugë administrative të akteve dhe kontratave administrative, shfuqizimit apo revokimit të tyre nga organet kompetente;
- dënohet subjekti/zyrtari, i ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit;
- goditet akti/kontrata në kushtet e konfliktit të interesit;
- kalimi i barrës së dëmshpërblimit zyrtarit që ka vepruar me keqbesim.

Ndërkohë, kompetencën për masën disiplinore e ka vetëm institucioni epror.

Kjo është e kuptueshme, pasi i vetmi ndëshkim që ka kompetencë ky komision është vlerësimi i masës disiplinore lidhur me anëtarin e AMA-s, të zgjedhur prej tij, në rastet kur konkludohet se ky anëtar është në kushtet e papajtueshmërisë apo konfliktit rast pas rasti dhe/apo atij të vazhdueshëm të interesit, duke vazhduar gjatë gjithë mandatit të tij si zyrtar i zgjedhur nga Kuvendi me angazhim privat të ndaluar nga ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit”.

Këtë të drejtë ia jep ligji 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, i ndryshuar, neni 6 “Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit”; neni 41 “Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji në institucionet publike janë: a) eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë, brenda një institucioni publik; b) drejtoritë, njësitë e burimeve njerëzore apo njësi të ngarkuara a të ngritura posaçërisht, sipas nevojës dhe mundësive të çdo institucioni publik; c) institucionet eprore”, dhe neni 45 i tij, sipas të cilit “çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj nga zyrtarët përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative”. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve. Për masat disiplinore të marra nga institucionet përkatëse, njoftohet rast pas rasti Inspektorati i Lartë.

Detyrimi i marrjes së masave për shmangien e konfliktit shtrihet në të gjithë linjën hierarkike, duke filluar nga vetë zyrtari e duke vazhduar me radhë te të gjithë eprorët dhe institucionet eprore (pika 4 e nenit 37). Në rast se zyrtari dhe/ose eprori nuk marrin masat e duhura për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit rast për rast të interesit, ligji “Për parandalimin e konfliktit të interesit” parashikon dënime administrative, si dhe masa disiplinore që jepen në nenet 44 dhe 45 të tij.

Në zbatim të ligjit për konfliktin e interesit, “parimi i proporcionalitetit” është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari ose institucioni publik me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë ose kompetencat e zyrtarit, aq më të shumta janë kufizimet e interesave të zyrtarit dhe aq më të ashpra janë dënimet.

Zyrtari, eprori ose institucioni epror njoftojnë në çdo rast Inspektoratin e Lartë për masat e marra për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave.

Lidhur me parashtrimet e mbrojtjes së zotit Bregu, që kryetari i AMA-s ishte në dijeni për faktin, komisioni arsyeton se këto informacione nuk përbëjnë justifikim apo nuk e zhbëjnë faktin e ndodhur në shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit” dhe, si pasojë, nuk ndryshojnë pasojat e ardhura.

Së pari, Kryetari i AMA-s mund të ketë marrë dijeni më herët për tokën, thjesht si një informacion personal dhe jo zyrtar, pa ditur për ndalesat e ligjit apo palën me të cilat është lidhur kontrata.

Së dyti, fakti që z.Bregu është konsultuar me juristin, nuk përbën argument që duhet marrë si ezaures për detyrimet ligjore, pasi, në radhë të parë, subjekti ka detyrimin të njohë vetë të drejtat, detyrimet dhe sanksionet e ligjit, që në momentin kur bëhet, për shkak të funksionit të tij, subjekt i të drejtave dhe detyrimeve të tij, më tej të konsultohet me personat e ngarkuar nga ligji dhe, më tej akoma, në vet ILDKPKI. Në parimin e përgjithshëm të së drejtës, *mosnjohja e ligjit, nuk përbën shkak për moszbatimin e tij dhe shkarkimin e subjektit nga përgjegjësia ligjore.*

Së treti, deklarimi i tokës është detyrim sipas ligjit të deklarimit të pasurisë. Ndërkohë, sipas ligjit të PKI-së, zyrtari ka detyrimin ta konstatojë vetë rastin dhe ta parandalojë e zgjidhë atë. Deklarimi në ILDKPKI për vetë procedurat që ndjek ky institucion dhe etapat e afatet mbi të cilat ILDKPKI-ja operon për të ushtruar kontroll të plotë apo hetime administrative mbi subjektin deklarues të pasurisë, nuk mund të përkojnë apo përdoren si argument mbrojtës në rastin individual, pasi ato janë procedura që i parashikon ligji 9049/2003, për kontrollin e shumë elementëve për deklarimin e pasurisë.

Ndërkohë, është detyrë e vetë zyrtarit, në radhë të parë, të marrë masat e tij për moskryerjen e veprimeve dhe angazhimeve/aktivitetetve private, të cilat mund të bien në konflikt me ligjin.

Siç dhe referuar provave të sjella nga mbrojtja ligjore, nuk rezulton që në korrespondencat me inspektoren e ILDKPKI-së të ketë ndonjë fakt konkret, që vërteton se nga ky institucion i është konfirmuar se toka e lidhur nuk është në kushtet e pengesës së ligjit për të ushtruar detyrën si anëtar i AMA-s. Korrespondecat nuk pasqyrojnë fare një moment konkret, ku të flitet për deklarimin e tokës dhe verifikimin e saj në raport me detyrimet e ligjit të PKI-së.

Sa më sipër, nga kalimi i barrës së provës, nga zyrtari nuk rezulton e vërtetuar e kundërta.

V. Lidhur me pretendimet mbi themelin e çështjes:

Komisioni vlerëson se anëtari i referohet në mënyrë të gabuar dispozitave ligjore të ligjit të PKI-së, duke arsyetuar se ndalimi ligjor për anëtarin e AMA-s është vetëm lidhur me juridiksionin dhe fushën e medias, dhe jo me një aktivitet që nuk bie në fushëveprimin e aktivitetit dhe funksionit të anëtarit të AMA-s. Për këto arsyeime, komisioni ka dhënë sa më lart shpjegimet lidhur me ndalesën që parashikon ligji, në nenin 21 të tij, të cilin e lidh jo me vendimmarrjen, as me fushën, por me funksionin.

Kjo ndalesë nuk ka lidhje me vendimmarrjen e anëtarit të AMA-s gjatë ushtrimit të funksionit të tij, sepse nuk ka lidhje me aktivitetin e tij publik, por është e lidhur me funksionin e zyrtarit. Në këtë rast, anëtari i AMA-s ka ndalim të natyrës absolute, neni 21 i ligjit të PKI-së, për të lidhur kontratë me një institucion publik të çfarëdo lloji qoftë, përfshirë edhe kontratë qeraje.

Ky ndalim është vetëm për shkak të funksionit publik dhe jo të vendimmarrjes së tij në funksionin publik. Në këtë kuptim, rasti përbën papajtueshmëri që lidhet me funksionin dhe jo me konfliktin e mundshëm të funksionit publik me ekzistencën e interesit privat.

Për sa sqaruam më lart, deri në këto momente, vlerësojmë se z.Bregu është në kushtet e pengesës për të lidhur kontratë me një institucion publik, ndërkohë që deklarimi i bërë gjatë kandidimit të tij në vitin 2016 për rizgjedhje në një mandat të dytë, ka patur objekt krejt tjetër të deklarimit dhe për një tjetër dispozitë ligjore ndaluese sipas ligjit të medias, i cili në terma të ngjashëm është edhe i parashikuar në ligjin e PKI-së. Gjykojmë se të dyja këto ndalime ekzistojnë për t'u zbatuar nga një anëtar i AMA-s.

VI. Moszbatimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe legjislacionit të lidhur me të dhe akteve të vetë AMA-s.

I gjithë ky kuadër ligjor, për vetë periudhën kur zoti Bregu ka qenë në funksionin e anëtarit, duhej të ishte në vëmendje për t'u zbatuar në çdo rrethanë apo situatë që mund të krijonte ai si individ, në raport me funksionin e mandatuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Legjislacioni në fuqi, i cituar më sipër, është detyrues për t'u respektuar dhe zbatuar nga çdo kategori zyrtarësh të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë. Kufizimet, ndalimet dhe sanksionet që normon ky legjislacion janë të zbatueshme për çdo anëtar, në raport me funksionin që ato marrin me vendim të Kuvendit, kur ato konstatohen dhe verifikohen si të tilla.

Jemi në kushtet kur është konstatuar një veprim juridik, që ka tre vjet që ka sjellë si pasojë situatën e paligjshmërisë së ushtrimit të detyrës së anëtarit të AMA-s, në kushtet e

hapura dhe në shkelje të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, por edhe të detyrës që i ka ngarkuar ligji organik.

Në kuptim të ligjit të konfliktit të interesit, zyrtari Zylyftar Bregu nuk i ka kryer në mënyrë të drejtë detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Përtej faktit të raportuar, ky anëtar ka cenuar imazhin dhe reputacionin që AMA me përpjekje mund të ketë krijuar në opinionin publik lidhur me pavarësinë dhe integritetin e anëtarëve të saj. Në këtë situatë, ku veprimtaria e AMA-s është edhe në fokus të qytetarit dhe interesit publik, për shkak të procesit të digjitalizimit, si dhe duke qenë autoriteti që mbron dhe promovon lirinë e medias dhe të drejtën e informimit, ky fakt ndikon negativisht, duke i shkaktuar dëm moral institucionit.

Anëtarët e institucioneve të pavarura që zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë, duhet të kenë integritet të lartë profesional e moral, të gëzojnë besimin e publikut dhe të Kuvendit se do ta ushtrojnë detyrën e tyre në funksion të ligjit dhe do të jenë të angazhuar maksimalisht të arrijnë objektivat dhe misionin e tij.

Konkluzion

Pas verifikimit të situatës së paligjshmërisë dhe gjendjes aktuale që është krijuar për anëtarin në fjalë, në kushtet e papajftshmërisë së ushtrimit të funksionit që prej vitit 2015 e deri me sot, duke qenë se bëhet fjalë për një fakt të ndodhur që para tre vjetësh dhe të konstatuar së fundi, komisioni doli në konkluzionin se nuk ndodhet në kushtet kur veprojnë masat parandaluese, që përcakton ligji për parandalimin e gjendjes së konfliktit në momentin kur ende nuk është lidhur kontrata dhe të fillonte efektet e saj. Pra, nuk mund të zbatohen masat dhe hapat që parashikohen në nenet 37 dhe 38 të ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”. Sot pasoja e verifikuar dhe zgjidhja e tyre shkon në një fazë më të avancuar.

Për sa më lart, komisioni, si organ i legjitimuar për të vendosur për çështjen, në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, ligjit “Për mediet audiovizive në RSH” dhe Rregullores së Kuvendit, pasi vlerësoi të gjitha elementet ligjore dhe faktike të situatës reale, nga e cila rrjedh edhe nevoja për të proceduar, merr vendimin përkatës, që e vlerëson në përputhje me misionin e tij kushtetues të kontrollit të zbatimit të ligjit, duke propozuar masat për përgjegjësinë disiplinore të personit.

Në aspektin procedural, rasti u trajtua në përputhje me parimin kushtetues dhe të jurisprndencës së GJEDNJ-së, dhe në veçanti të asaj shqiptare, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, duke i siguruar anëtarit të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu, të drejtën për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, si elementë thelbësorë të së drejtës që zbatohen si në procedurat gjyqësore, ashtu edhe në procedurat parlamentare dhe ato administrative:

- Kodin e Procedurave Administrative;
- ligjin 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit”, i ndryshuar;
- ligjin 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”
- Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga anëtari i AMA-s, bazuar në provat e administruara dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, mbështetur në sa më sipër, konstaton se:

“Zoti Bregu është në kushtet e shkeljes së ligjit të PKI-së prej tre vjetësh, pasi ka lidhur kontratë qiraje me një institucion publik, në kushtet kur është i ndaluar nga ligji në mënyrë absolute një veprim i tillë. Ky veprim bie ndesh me ushtrimin e funksionit të anëtarit të Autoritetit të Mediave Audiovizive”.

Pasi kemi dëgjuar në të gjitha seancat dëgjimore të gjitha pretendimet e zotit Bregu, është përgatitur ky material, që lexova, të cilin ju e keni pasur në *e-mail* dhe keni pasur mundësinë ta lexoni. Kush ka ndonjë pyetje, apo dëshiron të bëjë një koment?

(Reagim pa mikrofon.)

Unë propozoj ta hedhim në votë propozimin e ardhur. Të gjitha provat na çojnë në përfundimin se zoti Bregu është në kushtet e konfliktit të interesit. Duke qenë se ndodhet në këto kushte, duhet të lirohet nga kjo detyrë. A jeni dakord për këtë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne jemi duke plotësuar kuorumin, pra jemi 11 veta.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë. 10 do të marrin pjesë në votim. Unë për arsye të konfliktit të interesit me personin në fjalë, do të abstenoj, kështu që kërkoj mirëkuptimin e grupit. Pra mund të vazhdojmë sipas procedurës.

Milva Ekonomi – Ne si komision marrim vendimin për t’i propozuar seancës plenare lirimin e zotit Zylyftar Bregu nga detyra e anëtarit të AMA-s. Në bazë të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, nenit 12 të ligjit 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 45 të ligjit 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” dhe nenit 115 të Rregullores së Kuvendit, vendosëm që zoti Zylyftar Bregu të lirohet nga detyra e anëtarit të AMA-s. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Kush është dakord me projektvendimin? Një vendim kemi marrë dhe një votim do të bëjmë.

Të gjithë jemi dakord.

Bashkë me sekretarinë e komisionit do të përgatisim raportin për t'ia kaluar seancës plenare të ditës së enjte. Pra, komisioni ia përcjell këtë raport dhe projektvendimin përkatës seancës plenare.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pra, e kalojmë me shumicë votash. Janë 10 anëtarë, që morën pjesë në mbledhje. E kemi kuorumin e nevojshëm. Kemi votuar të 10-të. Njëri nga ne është tërhequr në votim, pra zoti Ylli. 9 veta kanë votuar pro, pra shumica, dhe kemi rezultatin 9 pro, 1 ka abstenuar.

Pra, ky vendim miratohet.

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi i korrespondencës drejtuar komisionit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fideli Ylli, Musa Ulqini, Vilma Ekonomi, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Bujar Çela, Besnik Baraj (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Shezai Rrokaj.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Kisha lënë edhe një mbledhje tjetër, të cilën po mendoja ta bëja nesër, por me detyrat që morëm sot, kam përshtypjen se secili nga ju duhet të shkojë në zonë. A do të më jepni mundësinë të zhvillojmë një mbledhje tjetër, pra, mbledhjen e nesërme ta bëjmë sot?

Mbledhja që kishim lënë për nesër ishte për të parë korrespondencën drejtuar komisionit.

Në fakt, na kanë ardhur disa shkresa, për të cilat kemi rënë dakord bashkë. Na ka ndihmuar edhe sekretaria për të mbaruar disa nga detyrat. Për shembull, ka ardhur një kërkesë nga zoti Kule, të cilën ia kemi kaluar Ministrisë së Arsimit për konfliktin që ka zoti Mynyr Koni me zotin Kule. Kjo është një çështje që po trajtohet.

Një tjetër gjë është që, pas dëgjësive për buxhetin, i kemi kaluar një letër Ministrisë së Arsimit për personat me aftësi të kufizuara që të kishin një pikë fokale në ministri.

Çfarë kemi tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne i kemi ndjekur të gjitha shkresat që kanë ardhur dhe i kemi kaluar për procedurë sipas funksioneve përkatëse.

A ka çështje për diskutim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ajo ka ardhur, por ne nuk kemi bërë dëgjësën, sepse ne i kërkuam një informacion Inspektoratit të Punës për situatën e kontratave të gazetarëve dhe ata kanë kthyer përgjigje. Ne, si komision, nuk kemi bërë dëgjësë për këtë, por kemi qenë të thirrur te konferenca e IV vjetore që bënte OSBE-ja, ku kjo çështje ishte për trajtim. Atje, unë bashkë me Musain, kemi dhënë një propozim si komision, që në rastet kur ata kanë nevojë të shkojnë në thellime të situatës së gazetarëve, duhet të punohet në dy forma:

Së pari, të shikohet lista me numër ID-je e të gjithë atyre që kanë aderuar në shoqatën e gazetarëve, ku numri i ID-së të shkojë te Sigurimet shoqërore, të merret situata e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe të kalohet te paga. Domethënë, të bëhet një projekt në atë që quhet *datadiging*, që germon në data dhe shikon se si është situata dhe pastaj kalojmë me një propozim konkret.

Kur ishim tek aktiviteti me AMA-n, diskutuam për kontratën tip nëse mund të ketë një të tillë midis punëmarrësit dhe punëdhënësit në fushën e gazetarisë.

Gjithashtu, kemi një letër që ka ardhur nga CRCA-ja dhe Rrjeti Kombëtar i të Rinjve në Shqipëri, të cilët kërkojnë seancë urgjente për buxhetin e arsimit në Shqipëri. Ne e kemi bërë dëgjësën dhe kur të shohim se si do të shkojë situata me buxhetin, që është kthyer në Komisionin e Ekonomisë, do t'i thërrasim, por për momentin nuk e kemi të mundur.

Shoqata e Komunitetit Egjiptian ka bërë një kërkesë lidhur me bursat e tyre, por ne do t'i thërrasim në takim, pasi të mbarojë dialogu që studentët kanë filluar të bëjnë me Kryeministrin e Shqipërisë lidhur me çështjet e arsimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te kërkesat e studentëve janë caktuar 8 pika që Kryeministri ka kërkuar të dialogojë me studentët, ku midis pikave kryesore është edhe bursa për të verbrit dhe grupet etnike. Ne kemi diskutuar këtu dhe kemi pasur edhe përfaqësuesin e sindikatave të personave me aftësi të kufizuara, i cili tregoi për një korrespondencë me zonjën Nikolla për bursat e fëmijëve të invalidëve. Ne këtë kërkesë ia përcollëm zonjës Nikolla, por ata kërkojnë një dëgjues tjetër, që është e drejta tyre dhe detyrimi ynë ta bëjmë atë, por duhet të shohim se si do të shkojë situata me studentët, në mënyrë që t'i thërrasim.

Meqenëse çështja e korrespondencave ka qenë një çështje që e kemi pasur në vëmendje, është mirë që komunikimi të vazhdojë edhe me *e-mail-e*, pasi mund të jetë e nevojshme që problemi të marrë sa më shpejt zgjidhje.

Për momentin dimë që seancë plenare ka në datat 20 dhe 21.

Në mbyllje të këtij sesioni parlamentar, duhet të bëjmë një reflektim.

Së pari, nuk ishte fat i mirë që nuk e kishim prezent opozitën, sepse, kur opozita është e pranishme, ka një lloj përqendrimi nga ana jonë për t'i parë gjërat me më shumë debat, jo dialog. Por pavarësisht se ata nuk ishin dhe nuk na bënë që t'i shohim gjërat me debat, na bënë që t'i shohim me dialog dhe kemi arritur në konkluzionin që, edhe në mungesë të tyre, të gjithë së bashku të kemi një performancë të mirë, sepse i kemi parë çështjet më me qetësi, duke realizuar disa reflektime dhe konkluzione për ligjet, projektligjet dhe kërkesat që na kanë ardhur.

Së dyti, duhet të falënderojmë pafund sekretarinë e komisionit dhe këshilltarët, të cilët na kanë mbështetur në punën tonë. Domethënë, një falënderim shkon për zonjën Mero, zotin Belaj, zotin Bici dhe zonjën Kadare. Ndërkohë kemi edhe të rinjtë që na kanë mbështetur dhe na kanë ndjekur në aktivitete. Ky ka qenë një vit që jemi munduar të prodhojmë raporte.

Ajo që kemi lënë pa bërë, por që do ta bëjmë vitin që vjen është që duhet të bëjmë dy vizita në trashëgimitë tona kulturore dhe të mbyllim një raport përmbledhës me çështjet siç i mendojmë ne, të cilat i kemi hasur gjatë lëvizjes nga njëri *sajt* i trashëgimisë në një tjetër. Bashkërisht kemi arritur të konkludojmë disa gjëra dhe besoj se deri nga fundi i shkurtit ne mund të mbyllim një raport dhe t'ia çojmë Ministrisë së Kulturës. Vitin që vjen do të bëjmë vizitë në universitete dhe pastaj do të shohim se çfarë zhvillimi do të marrë i gjithë procesi legjislativ në vend.

Ju faleminderit shumë!

Bujar Çela – Meqenëse është mbledhja e fundit për këtë sesion, krahas falënderimeve që bëtë ju si drejtuese e komisionit, unë propozoj një format të ri, në mënyrë që të mos ndiejmë dhimbjen e mungesës së opozitës, unë propozoj ta zëvendësojmë me një duartrokitje.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA